

TË RINJTË në INTEGRIME (III)

Transformimi dhe zgjerimi i Aleancës Veriatlantike

Transformimi i NATO-s

Kur u themelua Aleanca në 1949, Bashkimi Sovjetik shikohej si kërcënimi kryesor për lirinë dhe pavarësinë e Evropës Perëndimore. Ideologjia komuniste, qëllimet politike, metodat dhe kapaciteti ushtarak nënkuptonte që, çfarëdo të kenë qenë synimet e vërteta të Bashkimit Sovjetik, asnjë qeveri perëndimore nuk do të guxonte të injoronte mundësinë e konfliktit. Si rezultat i kësaj situatë, nga 1949 deri në fund të viteve 80 (periudha e njohur si Lufta e Ftohtë) detyra kryesore e Aleancës ishte të mirëmbante kapacitete të mjaftueshme ushtarake për të mbrojtur anëtarët e vet ndaj çdo forme agresioni nga Bashkimi Sovjetik dhe Traktati i Varshavës. Stabiliteti i garantuar nga NATO gjatë kësaj periudhe, e ndihmoi Evropën Perëndimore në tërësi, të rindërtonte lulëzimin e vet pas Luftës së Dytë Botërore, duke krijuar besimin dhe parashikueshmërinë, si parakushte themelore për rritjen ekonomike.

Politikat për të cilat vendet anëtarë të NATO-s kanë rënë dakord, kanë evoluar në mënyrë të vazhdueshme, në reflektim të strategjike në ndryshim. Qysh nga fundi i Luftës së Ftohtë, politikat dhe strukturat e Aleancës janë transformuar në mënyrë themelore. Gjithashtu, është zgjeruar edhe koncepti i mbrojtjes për të përfshirë dialogun dhe bashkëpunimin praktik me vendet e tjera jashtë Aleancës, si mjeti më i mirë për të forcuar sigurinë Euro-Atlantike.

Sot, NATO është më tepër se një Aleancë mbrojtjeje. Në të vërtetë ajo është shtrirë duke arritur deri tek ish kundërshtarët e vet dhe po punon tani për të ndërtuar dhe mbrojtur paqen dhe sigurinë në mbarë zonën Euro-Atlantike. Për të arritur këtë, Aleanca po ndërmerr një numër detyrash edhe më të mëdha dhe po adopton mënyra pragmatike, novatore, dhe gjithnjë e më tepër elastike për të zgjidhur ato që janë në mënyrë të paevitushme çështje komplekse. Në këtë proces është forcuar roli qendror i NATO-s në garantimin e sigurisë së zonës Euro-Atlantike dhe shumë vende partnere po kërkojnë të anëtarësohen në Aleancë. Tre nga vendet e Evropës Qendrore e Lindore, - Republika Çeke, Hungaria e Polonia - e arritën këtë objektiv në 1999. Shtatë vende të tjera - Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia e Sllovenia - e bënë këtë në 2004.

Transformimi i NATO-s gjatë dekadës së kaluar është karakterizuar nga një seri iniciativash vizionare, si përgjigje konkrete dhe shumë praktike ndaj mundësive dhe sfidave të sigurisë në ambientin pas luftës së Ftohtë. Këto përfshijnë Partneritetin për Paqe, marrëdhënie speciale me Rusinë e Ukrainën, një dialog me vendet e Mesdheut, Planin e Veprimit për Anëtarësim për të ndihmuar vendet aspiruese të plotësojnë standardet e NATO-s, dhe bashkëpunimin efektiv për sigurinë me Bashkimin Evropian, Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Evropian (OSBE) dhe Kombet e Bashkuara.

NATO është angazhuar aktivisht edhe për të përballuar sfidat e sigurisë në evoluim duke drejtuar operacione për menaxhim krizash në Ballkan dhe duke u angazhuar që të operojë kur dhe ku të jetë nevoja.

Për më tepër, për të përmirësuar kapacitetin e vet që të marrë përsipër misione të reja, NATO po adapton dhe forcon kapacitetet e veta. Për këtë qëllim, në Samitin e Pragës në Nëntor 2002, u lançuan tri iniciativa kyçe: krijimi i Forcës së Reagimit të NATO-s, reforma e strukturës së komandës ushtarake dhe Angazhimi për Kapacitetet i Pragës, nëpërmjet të cilit boshllëqet në kapacitete do të përballohen nga angazhimet individuale të vendeve anëtare dhe iniciativave të bashkëpunimit.



Samiti i NATO-s
në Berlin, prill 2011

Zgjerimi i NATO-s

Anëtarësia në NATO është e hapur për çdo vend evropian. Neni 10 i Traktatit të Uashingtonit u lejon vendeve ekzistuese të ftojnë çdo vend evropian që është në pozicion të avancojë më tej parimet e Traktatit dhe të kontribuojë për sigurinë e zonës së Atlantikut Verior, që të bëhet anëtar i NATO-s. 12 anëtarët themelues të NATO-s janë rritur sot në 28, pas gjashtë raundesh zgjerimi.

Historiku i zgjerimit të NATO-s

Viti i zgjerimit	Numri i anëtarëve	Shtetet
Themelimi i NATO-s 1949	12	SHBA, Britania e Madhe, Kanadaja, Franca, Italia, Belgjika, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Danimarka, Islanda, Portugalia
18 shkurt 1952	14	Greqia, Turqia
9 maj 1955	15	Gjermania Perëndimore
30 maj 1982	16	Spanja
12 mars 1982	19	Republika Çeke, Hungaria, Polonia
29 mars 2004	26	Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia, Sllovenia
1 prill 2009	28	Shqipëria, Kroacia



QEVERIA e MALIT TË ZI
Ekipi bashkërendues për implemetimin e
Strategjisë komunikuese
për integrimet euro-atlantike

